



V E N D I M

K.P.P. 222/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.04.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Azizolli” shpk dhe “Myrto Security” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-42460-01-29-2018 me objekt: “Ruajtja e godinës së qendres polivalente për shërbimet e përkujdesit shoqëror Polican me roje private” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.079.047.⁷⁶ lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Polivalente për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror Polican.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Myrto Security” shpk, “Azizolli” shpk dhe “Lybeshari” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Lybeshari” shpk
Lagjia “Kushtrim” Berat

“Nazeri 2000” shpk
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Qendra Polivalente për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror Polican Polican

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 29.01.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. REF-42460-01-29-2018 me objekt: “Ruajtja e godinës së qendres polivalente për shërbimet e perkujdesit shoqëror Polican me roje private” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.079.047.⁷⁶ lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra polivalente për shërbime të perkujdesit shoqëror Polican.

II.2. Në datën 19.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 20.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Start 2000	pa ofertë	I skualifikuar
Res 03	pa ofertë	I skualifikuar
Azizolli	5,290.99	I kualifikuar
Myrto Security	5,379.86	I kualifikuar
Lybeshari	5,481.11	I kualifikuar
Aulona Pol 1	5,696.19	I kualifikuar
Nazeri 2000	5,696.19	I kualifikuar
A.E.K Security	5,697.17	I kualifikuar

II.5. Në datën 26.02.2018 operatori ekonomik “Lybeshari” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Përpara shoqërisë sonë është renditur shoqëria Azizolli shpk dhe shoqëria Myrto Security. Gjykojmë se KVO është mbështetur në mënyrën e vet të llogaritjes por ne konsiderojmë se dy ofertat e renditura para nesh kanë një vlerë anomalisht të ulët dhe nuk i përmbahet VKM për përcaktimin e pagës minimale prej 36000 lekë në muaj. Në këto kushte i kërkojmë autoriteti kontraktor rivlerësimin e ofertave e për pasojë skualifikimin e shoqërive të renditura në vendin e parë dhe të dytë për mospërmbushje të kriterit bazë të pagës minimale për një roje dhe shpalljen fitues të shoqërisë Lybeshari shpk.

II.6. Në datën 27.02.2018 me shkresën nr. 98/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Lybeshari” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 05.03.2018, pala ankimuese “Lybeshari” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Shoqëria Azizolli, Myrto Security, Lybeshari nuk kanë parashikuar drejt pagën minimale, shtesat për turnin e dytë dhe të tretë si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.*
- *Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Azizolli, Myrto Security, Lybeshari, Aulona Pol 1 pasi nuk kanë paraqitur vërtetim lëshuar nga OSHEE për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë.*
- *Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Azizolli, Myrto Security, Lybeshari, Aulona Pol 1 pasi këto shoqëri nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për certifikata të vlefshme brenda afatit katër vjeçar për numrin e kërkuar nga AK. Shoqëria Aulona Pol 1 nuk ka paraqitur certifikata të vlefshme për Qarkun Berat.*
- *Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Azizolli, Myrto Security, Lybeshari, Aulona Pol 1 pasi këto shoqëri nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për paraqitjen e vërtetim xhiro për vitin 2017.*
- *Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë Azizolli, Myrto Security, Lybeshari, Aulona Pol 1 pasi këto shoqëri nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për AKEP radikomunikim dhe alarm me zonë mbulimi qytetin Polican.*
- *Autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë Myrto Security , Aulona Pol 1 pasi nuk kanë paraqitur akt miratimi dhe vërtetim nga DVP Berat.*

II.9. Në datën 27.02.2018, me shkresën nr.96/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.10. Në datën 05.03.2018 pala ankimuese “Nazeri 2000” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.98/4 prot, datë 12.03.2018, protokolluar me tonën me nr.414/2 prot datë 15.03.2018 dhe shkresës nr.96/4 prot datë 12.03.2018 protokolluar me tonën me nr.420/2 datë 15.03.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorëve ekonomikë “Lybeshari” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorëve ekonomikë “Azizolli” shpk, “Myrto Security” shpk, dhe pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorëve ekonomikë “Azizolli” shpk, “Myrto Security” shpk, “Lybeshari” shpk me argumentat se “nuk kanë parashikuar drejt pagën minimale, shtesat për turnin e dytë dhe të tretë si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen të dhënat e shërbimit si më poshtë:

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /dite	Afati i perlllogarituar ne dite
1.	Sherbimi i ruajtjes se godines se qendres polivalente per sherbime te perkujdesit shoqeror Polican per 1 vend roje me 2 turne (II-III)	dite	1		
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Sqarime:

1. Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.
2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 2 turne (3.32 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vendroje me 2 turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave te mesiperm, duke pasqyruar te gjitha koston per te cilat kane detyrime ligjore ne zbatim te VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vendroje me tre turne te llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e koston në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.2. Në shtojcën 6 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit" pika 7 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Operatorët ekonomikë duhet te paraqesin analizen e koston ditore të kryerjes së shërbimit të ruajtjes me roje per oferten e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime).

III.1.3. Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike ” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen të dhënat e shërbimit si më poshtë:

Shërbimi në një vendroje në hyrjen kryesore me dy turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (16 orë në ditë)

Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.

III.1.4. Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit ” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private” – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e shërbimit: _____

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
1	2	3.32	12 muaj Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, dokumentacionit të operatorëve ekonomikë si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton mangësi në procesin e hartimit të dokumentave të tenderit, pasi sikundër është pasqyruar edhe më sipër, në to jepen të dhëna kontradiktore sa i takon numrit të punonjësve të nevojshëm për realizimin e këtij shërbimi ku në njërin anë përcaktohet 1 vend-roje me 2 turne (3.32 roje) , ndërsa më poshtë citohet një vendroje me tre turne te llogaritet 4.98 roje.

Një përcaktim i tillë ka sjellë konfuzion në rradhët e operatorëve ekonomikë pjesmarrës ku konstatohet se në përllogaritjen e ofertave të paraqitura prej tyre (e konkretisht për përllogaritjen e shtesave për turin e dytë dhe të tretë) disa kanë marrë për bazë koeficientin 3.32 roje disa të tjerë 4.98 roje. Kjo ka bërë që operatorët ekonomikë të vendosen në pozita të

pabarabarta konkurimi, pasi sqarojmë se të dhënat e shërbimit të tilla si numri i rojeve të nevojshme për realizimin e shërbimit, kohëzgjatja e kontratës, numri i vendorojeve ku do të realizohet shërbimi si dhe përcaktimi i turneve përkatëse janë të dhëna të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në ofertën ekonomike të operatorëve ekonomikë pjesmarrës e për këtë shkak duhet të pasqyrohen me saktësi nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga përcaktimet e mësipërme gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar qartë dhe saktë numrin e rojeve të nevojshme për realizimin e shërbimit pasi ka dhënë dy përcaktime të ndryshme të cilat kanë ndikuar në mënyrën e ofertimit të operatorëve ekonomikë pjesmarrës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, mospërcaktimi i saktë i informacionit në lidhje me numrin e rojeve apo përcaktimi i të dhënave kontradiktore në lidhje me të , ka krijuar konfuzion tek ofertuesit lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së ofertave të tyre ekonomike dhe njëherazi ka vështirësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procesin e vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ndërmjet tyre.

III.1.6. KPP gjykon se dokumentat e tenderit duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e shërbimeve, si dhe kërkesave të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit të ruajtjes me roje, (pra të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar).

Mungesa e elementëve të sipërcituar shërben si pengesë për konkurrencën e drejtë në prokurimin publik, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të prokurimit publik të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ndaj Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet, pasi në rastin konkret ndodhemi në kushtet e parashikuara në nenin 64, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: ... b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj.” Autoriteti kontraktor në rishpallje të saj duhet të përcaktojë qartë informacionin lidhur me numrin e punonjësve të shërbimit, në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Në lidhje me shpenzimet proceduriale, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që ky i fundit, megjithëse i vënë në lëvizje nga ana e operatorëve ekonomikë, për shkaqet e sipërcituara, nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e tyre , gjykon të kthejë tarifën e paguar nga operatorët ekonomikë ankimues.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të anulojë procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. REF-42460-01-29-2018 me objekt: “*Ruajtja e godinës së qendres polivalente për shërbimet e perkujdesit shoqëror Polican me roje private*” – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të percaktuara - me afat 12 muaj”, me fond limit 2.079.047.⁷⁶ lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 19.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Qendra Polivalente për Shërbime të Perkujdesit Shoqëror Polican.
2. Autoriteti kontraktor, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, të zhvillojë procedurën në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “Lybeshari” sh.p.k., dhe “Nazeri 2000” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 414 Protokoli, Datë 05.03.2018

Nr.420 Protokoli; Datë 05.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha